LIGJ
Nr. 30/2026

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN E METRIT, NËNSHKRUAR NË PARIS MË 20 MAJ 1875, TË NDRYSHUAR ME KONVENTËN E NËNSHKRUAR NË *SÈVRES* MË 6 TETOR 1921, DHE RREGULLOREN PËRKATËSE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën e Metrit, nënshkruar në Paris më 20 maj 1875, të ndryshuar me konventën e nënshkruar në *Sèvres*, më 6 tetor 1921, dhe rregulloren përkatëse, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.3.2026.

Shpallur me dekretin nr. 194, datë 7.4.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

KONVENTA E METRIT
DHE RREGULLORJA SHTESË

Byroja Ndërkombëtare e Peshave dhe e Masave

KONVENTA E METRIT

Neni një (1875)

Palët e Larta Kontraktuese zotohen të krijojnë dhe të mirëmbajnë, me shpenzime të përbashkëta, *një Byro Ndërkombëtare të Peshave dhe e Masave*, shkencore dhe të përhershme, me seli në Paris[1].

Neni 2 (1875)

---

[1] *Dekreti nr. 70-820 i 9 shtatorit 1970 që ka të bëjë me botimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës Franceze dhe Komitetit Ndërkombëtar të Peshave dhe i Masave, në lidhje me selinë e Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe i Masave dhe privilegjet e imunitetet e saj në territorin francez, e 25 prillit 1969 (botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës Franceze të 18 shtatorit 1970), ndryshuar me marrëveshjen e 7 qershorit 2005 dhe me shkëmbim shkresash më 6 dhe 23 korrik 2007, të ratifikuara me ligjin nr. 2008-738 të datës 28 korrik 2008 (botuar në Fletoren Zyrtare të Republikës Franceze të 30 korrikut 2008).*

Qeveria Franceze do të marrë masat e nevojshme për të lehtësuar blerjen ose, nëse është rasti, ndërtimin e një ndërtese të caktuar posaçërisht për këtë qëllim, sipas kushteve të përcaktuara nga Rregullorja që i bashkëngjitet kësaj Konvente.

Neni 3 (1875)

Byroja Ndërkombëtare do të funksionojë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen ekskluzive të një *Komiteti Ndërkombëtar të Peshave dhe e Masave*, ky vetë i vendosur nën autoritetin e një *Konference të Përgjithshme të Peshave dhe të Masave*, e përbërë nga të deleguar të të gjitha qeverive kontraktuese.

Neni 4 (1875)

Kryesimi i Konferencës së Përgjithshme të Peshave dhe e Masave i është caktuar presidentit në detyrë të Akademisë së Shkencave të Parisit.

Neni 5 (1875)

Organizimi i Byrosë, si dhe përbërja dhe atributet e Komitetit Ndërkombëtar dhe të Konferencës së Përgjithshme të Peshave dhe të Masave përcaktohen nga Rregullorja që i bashkëngjitet kësaj Konvente.

Neni 6 (1875)

Byroja Ndërkombëtare e Peshave dhe e Masave ngarkohet me:

1° Të gjitha krahasimet dhe verifikimet e prototipave të rinj të metrit dhe kilogramit;

2° Ruajtjen e prototipave ndërkombëtarë;

3° Krahasimet periodike të etalonëve kombëtarë me prototipat ndërkombëtarë dhe kopjet e tyre, si dhe ato të termometrave etalonë;

4° Krahasimin e prototipave të rinj me etalonët themelorë të peshave dhe të masave jometrike të përdorur në vendet e ndryshme dhe në shkenca;

5° Kalibrimin dhe krahasimin e shufrave gjeodezike;

6° Krahasimin e etalonëve dhe shkallëve të saktësisë, verifikimi i të cilave mund të kërkohet qoftë nga qeveritë, qoftë nga shoqatat shkencore, qoftë madje dhe nga artistet e dijetarët.

Neni 7 (1921)

Pasi Komiteti të ketë kryer një punë bashkërendimi të masave, në lidhje me njësitë elektrike, dhe kur Konferenca e Përgjithshme të ketë vendosur për to me votë unanime, Byroja do të ngarkohet për krijimin dhe ruajtjen e etalonëve të njësive elektrike dhe kopjeve të tyre, si dhe për krahasimin me këta etalonë, të etalonëve kombëtarë apo etalonëve të tjerë të saktësisë.

Përveç kësaj, Byroja është e ngarkuar me përcaktimet në lidhje me konstantet fizike, një njohje më e saktë e të cilave mund të shërbejë për të rritur saktësinë dhe për të siguruar më mirë uniformitetin në fushat të cilave u përkasin njësitë e përmendura më sipër (neni 6 dhe paragrafi 1 i nenit 7).

Së fundi, ajo është e ngarkuar me punën e bashkërendimit të përcaktimeve analoge të kryera në institute të tjera.

Neni 8 (1921)

Prototipat ndërkombëtarë, si dhe kopjet e tyre do të qëndrojnë të depozituar në Byro; qasja në depozitim do të jetë i rezervuar vetëm për Komitetin Ndërkombëtar.

Neni 9 (1875)

Të gjitha shpenzimet për krijimin dhe vendosjen e Byrosë Ndërkombëtare të Peshave dhe të Masave, si dhe shpenzimet vjetore të mirëmbajtjes dhe shpenzimet e Komitetit, do të mbulohen nga kontributet e shteteve kontraktuese, të përcaktuara sipas një shkalle të bazuar në popullsinë e tyre aktuale.

Neni 10 (1875)

Shumat që përfaqësojnë pjesën kontribuese të secilit prej shteteve kontraktuese do të derdhen, në fillim të çdo viti, nëpërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës, në *Caisse des dépôts et consignations* (Fondi i depozitave) në Paris, nga e cila do të tërhiqen, kohë pas kohe sipas nevojës, me urdhër të drejtorit të Byrosë.

Neni 11 (1875)

Qeveritë që do të përdornin të drejtën, e rezervuar për çdo shtet, për t'iu bashkuar kësaj Konvente, do të duhet të paguajnë një kontribut, shuma e të cilit do të përcaktohet nga Komiteti, mbi bazat e parashikuara në nenin 9 dhe që do të përdoret për përmirësimin e pajisjeve shkencore të Byrosë[2].

Neni III
(dispozita të shtuara nga Konventa e vitit 1921)[3]

Çdo shtet mund të aderojë në këtë Konventë duke ia njoftuar anëtarësimin e tij Qeverisë Franceze, e cila do të njoftojë të gjitha shtetet pjesëmarrëse dhe kryetarin e Komitetit Ndërkombëtar të Peshave dhe të Masave.

Çdo anëtarësim i ri në Konventën e 20 majit 1875 do të sjellë detyrimisht aderimin në këtë Konventë.

Neni 12 (1875)

Palët e Larta Kontraktuese rezervojnë të drejtën që, me marrëveshje të përbashkët, t'i bëjnë kësaj Konvente ndryshimet, për të cilat përvoja do të tregojë se janë të dobishme.

Neni 13 (1875)

Me përfundimin e një periudhe prej dymbëdhjetë vjetësh, kjo Konventë mund të denoncohet nga secila prej Palëve të Larta Kontraktuese.

Qeveria që do të përdorë të drejtën për të ndërprerë efektet e Konventës në lidhje me të, duhet të njoftojë qëllimin e saj një vit përpara, dhe, në këtë mënyrë, do të heqë dorë nga të gjitha të drejtat e bashkëpronësisë mbi prototipat ndërkombëtarë dhe mbi Byronë.

Neni 14 (1875)

Kjo Konventë do të ratifikohet sipas ligjeve kushtetuese të secilit shtet; ratifikimet do të shkëmbehen brenda një periudhe prej gjashtë muajsh në Paris, ose dhe më herët nëse është e mundur. Ajo do të hyjë në zbatim duke filluar nga data 1 janar 1876.

Në dëshmi të kësaj, të plotfuqishmit përkatës e kanë nënshkruar dhe kanë vendosur vulën e tyre

---

[2] Komiteti Ndërkombëtar i Peshave dhe i Masave, gjatë sesionit të tij të 49-të (tetor 1960), ka vendosur që kontributi (kontributi i hyrjes) i përmendur në këtë nen 11, duke nisur nga 1 janari 1961, do të jetë i barabartë me shumën e një kontributi vjetor.

[3] Shih njoftimin, f. 3

zyrtare.

SHTOJCË
RREGULLORE

Neni një (1875)

Byroja Ndërkombëtare e Peshave dhe e Masave do të vendoset në një ndërtesë të posaçme që siguron të gjitha garancitë e nevojshme për qetësi dhe qëndrueshmëri.

Ajo do të përfshijë, përveç ambientit të përshtatshëm për depozitimin e prototipave, salla për instalimin e krahasuesve dhe peshoreve, një laborator, një bibliotekë, një sallë arkivi, zyra pune për punonjësit dhe banesa për personelin e rojës dhe shërbimit.

Neni 2 (1875)

Komiteti Ndërkombëtar është i ngarkuar me blerjen dhe marrjen e pronësisë së kësaj ndërtese, si dhe vendosjen e shërbimeve për të cilat është destinuar.

Në rast se Komiteti nuk arrin të gjejë për të blerë një ndërtesë të përshtatshme, atëherë një ndërtesë e tillë do të ndërtohet nën drejtimin e tij dhe sipas projektit të tij.

Neni 3 (1875)

Me kërkesë të Komitetit Ndërkombëtar, Qeveria Franceze do të marrë masat e nevojshme që Byroja të njihet si institucion i dobisë publike.

Neni 4 (1875)

Komiteti Ndërkombëtar do të bëjë të mundur prodhimin e instrumenteve të nevojshme, si: krahasues për etalonët me vija dhe skaje, pajisje për përcaktimin e koeficientit absolut të zgjerimit, peshore për peshimin në ajër dhe në boshllëk, krahasues për shufrat gjeodezike, etj.

Neni 5 (1875)

Shpenzimet për blerjen ose për ndërtimin e ndërtesës dhe shpenzimet e instalimit dhe blerjes së instrumenteve dhe pajisjeve nuk mund ta tejkalojnë së bashku shumën prej 400 000 frangash.

Neni 6 (1921)

1. Financimi vjetor i Byrosë Ndërkombëtare përbëhet nga dy pjesë: njëra fikse, tjetra plotësuese.

2. Pjesa fikse është, në parim, 250 000 franga, por mund të rritet në 300 000 franga me vendim unanim të Komitetit. Ajo është në ngarkim të të gjitha shteteve dhe Kolonive autonome që kanë aderuar në Konventën e Metrit para Konferencës së Gjashtë të Përgjithshme.

3. Pjesa plotësuese përbëhet nga kontributet e shteteve dhe Kolonive autonome që kanë hyrë në Konventë pas kësaj Konference të Përgjithshme.

4. Komiteti është i ngarkuar, me propozim të drejtorit, të hartojë buxhetin vjetor, por pa e tejkaluar shumën e llogaritur sipas kushteve të dy paragrafëve të mësipërm. Ky buxhet u bëhet i njohur, çdo vit, në një raport financiar të posaçëm, qeverive të Palëve të Larta Kontraktuese.

5. Në rast se Komiteti do ta gjykojë të nevojshme, qoftë ta rrisë përtej 300 000 frangave pjesën fikse të financimit vjetor, qoftë të ndryshojë llogaritjen e kontributeve të përcaktuar nga neni 20 i kësaj Rregulloreje, ai do të duhet t'u drejtohet qeverive, me qëllim që t'u mundësojë t'u japin, në kohën e duhur, udhëzimet e nevojshme të deleguarve të tyre në Konferencën e Përgjithshme të radhës, në mënyrë që kjo të mund të marrë vendime të vlefshme. Vendimi do të jetë i vlefshëm vetëm

në rast se asnjë nga shtetet kontraktuese nuk ka shprehur, ose nuk do të shprehë në Konferencë një opinion të kundërt[4].

6. Nëse një shtet për tre vjet nuk ka kryer pagesën e kontributit të tij, ky ndahet midis shteteve të tjera, në përpjesëtim me kontributet e tyre. Shumat shtesë, që këto shtete derdhin për të plotësuar shumën e financimit të Byrosë, konsiderohen si një paradhënie ndaj shtetit që është në vonesë dhe u rimbursohen nëse ky shlyen kontributet e tij të prapambetura.

7. Avantazhet dhe prerogativat e dhëna nga aderimi në Konventën e Metrit pezullohen kundrejt shteteve deficitare prej tre vjetësh.

8. Pas tre vjetësh të tjerë, shteti deficitar përjashtohet nga konventa dhe llogaritja e kontributeve ribëhet në përputhje me dispozitat e nenit 20 të kësaj Rregulloreje.

Neni 7 (1875)

Konferenca e Përgjithshme, e përmendur në nenin 3 të Konventës, do të mblidhet në Paris, me thirrje të Komitetit Ndërkombëtar, të paktën një herë në çdo gjashtë vjet.

Ajo ka për mision të diskutojë dhe nxisë masat e nevojshme për përhapjen dhe perfeksionimin e sistemit metrik, si dhe të sanksionojë përcaktimet e reja metrologjike themelore që mund të jenë bërë në intervalin midis mbledhjeve të saj. Ajo pranon Raportin e Komitetit Ndërkombëtar mbi punimet e kryera dhe procedon, me votim të fshehtë, në rinovimin me gjysmën e Komitetit Ndërkombëtar.

Votimet në Konferencën e Përgjithshme bëhen nga shtetet; çdo shtet ka të drejtën e një vote.

Anëtarët e Komitetit Ndërkombëtar marrin pjesë automatikisht në mbledhjet e Konferencës; ata mund të jenë në të njëjtën kohë të deleguar të qeverive të tyre.

Neni 8 (1921)

Komiteti ndërkombëtar, i përmendur në nenin 3 të Konventës, do të përbëhet nga tetëmbëdhjetë anëtarë që u përkasin të gjithë shteteve të ndryshme.

Gjatë rinovimit, për gjysmë, të Komitetit ndërkombëtar, anëtarët që largohen do të jenë në radhë të parë ata që, në rast vendesh vakante, janë zgjedhur përkohësisht në intervalin midis dy sesioneve të Konferencës; të tjerët do të caktohen me short.

Anëtarët në largim janë të rizgjedhshëm.

Neni 9 (1921)

Komiteti Ndërkombëtar do të konstituohet duke zgjedhur vetë, me votim të fshehtë, kryetarin dhe sekretarin e tij. Këto emërime u njoftohen qeverive të Palëve të Larta Kontraktuese.

Kryetari dhe sekretari i Komitetit, dhe drejtori i Byrosë, duhet t'u përkasin vendeve të ndryshme.

Pasi konstituohet, Komiteti mund të kryejë zgjedhje të reja ose emërime vetëm tre muaj, pasi të gjithë anëtarët të jenë informuar për vendin vakant që ka sjellë nevojën për votim.

Neni 10 (1921)

Komiteti Ndërkombëtar drejton të gjitha punimet metrologjike që Palët e Larta Kontraktuese do të vendosin të kryejnë së bashku.

Përveç kësaj, ai është i ngarkuar, me mbikëqyrjen e ruajtjes së prototipave dhe etalonëve ndërkombëtarë.

Ai mundet, më në fund, të vendosë bashkëpunimin e specialistëve në çështjet e metrologjisë, dhe të bashkërendojë rezultatet e punimeve të tyre.

Neni 11 (1921)

[4] Në zbatim të kësaj procedure, që prej Konferencës së Trembëdhjetë të Përgjithshme të Peshave dhe të Masave (tetor 1968), financimet vjetore miratohen nga çdo Konferencë e Përgjithshme

Komiteti do të mblidhet të paktën një herë në dy vjet.

Neni 12 (1921)

Votimet brenda Komitetit zhvillohen me shumicë votash: në rast rezultati të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese. Vendimet janë të vlefshme vetëm nëse numri i anëtarëve të pranishëm është i barabartë me të paktën gjysmën e anëtarëve të zgjedhur që përbëjnë Komitetin.

Për respektimin e këtij kushti, anëtarët që mungojnë kanë të drejtë të delegojnë votat e tyre tek anëtarët e pranishëm, që do të duhet ta provojnë këtë delegim. I njëjti kusht zbatohet për emërimet me votim të fshehtë.

Drejtori i Byrosë ka të drejtën e një vote vendimmarrëse në Komitet.

Neni 13 (1875)

Në intervalin nga një sesion tek tjetri, Komiteti ka të drejtë të marrë vendime me korrespondencë.

Në këtë rast, që vendimi të jetë i vlefshëm, duhet që të gjithë anëtarët e Komitetit të jenë thirrur për të shprehur opinionin e tyre.

Neni 14 (1875)

Komiteti Ndërkombëtar i Peshave dhe i Masave plotëson përkohësisht vendet vakante që mund të krijohen brenda tij; zgjedhjet bëhen me korrespondencë, ku secili nga anëtarët thirret të marrë pjesë në to.

Neni 15 (1921)

Komiteti Ndërkombëtar do të hartojë një rregullore të hollësishme për organizimin dhe punimet e Byrosë dhe do të përcaktojë taksat që duhen paguar për punimet e jashtëzakonshme të parashikuara në nenet 6 dhe 7 të Konventës.

Këto taksa do të përdoren për perfeksionimin e pajisjeve shkencore të Byrosë. Nga tërësia e taksave të mbledhura nga Byroja mund të kryhet një pagesë vjetore në favor të Fondit të pensioneve.

Neni 16 (1875)

Të gjitha komunikimet e Komitetit ndërkombëtar me qeveritë e Palëve të Larta kontraktuese do të zhvillohen nëpërmjet përfaqësuesve të tyre diplomatikë në Paris.

Për të gjitha çështjet, zgjidhja e të cilave i takon një administrate franceze, Komiteti do t'i drejtohet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Francës.

Neni 17 (1921)

Një rregullore, e hartuar nga Komiteti, do të caktojë stafin maksimal për çdo kategori të personelit të Byrosë.

Drejtori dhe zëvendësit e tij do të emërohen me votim të fshehtë nga Komiteti Ndërkombëtar.

Emërimi i tyre do t'u njoftohet qeverive të Palëve të Larta kontraktuese.

Drejtori do të emërojë anëtarët e tjerë të personelit, në kufijtë e caktuar nga rregullorja e përmendur në paragrafin një më sipër.

Neni 18 (1921)

Drejtori i Byrosë do të ketë qasje në vendin e depozitimit të prototipave ndërkombëtarë vetëm në bazë të një vendimi të Komitetit dhe në prani të të paktën njërit prej anëtarëve të tij.

Vendi i depozitimit të prototipave mund të hapet vetëm me tre çelësa, ndër të cilët njëri do të jetë në zotërim të drejtorit të Arkivave të Francës, i dyti do të zotërohet nga kryetari i Komitetit, dhe i treti nga drejtori i Byrosë.

Vetëm etalonët e kategorisë së prototipave kombëtarë do të shërbejnë në punimet e zakonshme të krahasimit të Byrosë.

Neni 19 (1907)

Drejtori i Byrosë do t'i paraqesë në çdo sesion Komitetit:

1° Një raport financiar mbi bilancin e viteve të mëparshme, për të cilin, pas verifikimit, ai do të çlirohet nga detyrimet;

2° Një raport mbi gjendjen e pajisjeve;

3° Një raport të përgjithshëm mbi punimet e kryera që prej sesionit të mëparshëm.

Byroja e Komitetit Ndërkombëtar do t'u paraqesë, nga ana e saj, të gjitha qeverive të Palëve të Larta kontraktuese, një Raport vjetor mbi gjendjen administrative dhe financiare të Shërbimit, dhe që përmban parashikimet e shpenzimeve të vitit vijues, si dhe tabelën e pjesëve kontribuese të shteteve kontraktuese.

Kryetari i Komitetit do t'i raportojë Konferencës së Përgjithshme për punimet e kryera që prej mbledhjes së saj të fundit.

Raportet dhe botimet e Komitetit dhe të Byrosë do të hartohen në gjuhën frënge dhe do t'u komunikohen qeverive të Palëve të Larta kontraktuese.

Neni 20 (1921)

1. Shkalla e kontributeve, për të cilat bëhet fjalë në nenin 9 të Konventës, vendoset, për pjesën fikse, në bazë të financimit të treguar nga neni 6 i kësaj Rregulloreje dhe në bazë të popullsisë; kontributi normal i çdo shteti nuk mund të jetë më i ulët se 5 për 1 000, as më i lartë se 15 për 100 të financimit total, pavarësisht nga numri i popullsisë.

2. Për të vendosur këtë shkallë, në fillim përcaktohet se cilat janë shtetet që ndodhen në kushtet e duhura për këtë minimum dhe këtë maksimum; dhe pjesa e mbetur e shumës kontribuese ndahet midis shteteve të tjera, në përpjesëtim të drejtë me numrin e popullsisë së tyre.[5]

3. Pjesët kontribuese të llogaritura në këtë mënyrë janë të vlefshme për të gjithë periudhën kohore të përfshirë midis dy konferencave të përgjithshme të njëpasnjëshme, dhe nuk mund të modifikohen, në këtë interval, përveçse në rastet në vijim:

a) Nëse njëri nga shtetet aderuese gjatë tre viteve të njëpasnjëshme nuk ka kryer pagesat e tij;

b) Në të kundërt, nëse një shtet, që më parë ka pasur detyrime të papaguara për më shumë se tre vjet, i paguan kontributet e tij të prapambetura, ka vend për t'u kthyer qeverive të tjera paradhëniet e kryera prej tyre.

4. Kontributi plotësues llogaritet mbi të njëjtën bazë të popullsisë dhe është i barabartë me atë që shtetet e futura më parë në Konventë paguajnë në të njëjtat kushte.

5. Nëse një shtet që ka aderuar në Konventë deklaron se dëshiron ta shtrijë përfitimin e saj në një apo disa prej disa kolonive të tij joautonome, numri i popullsisë së këtyre kolonive do t'i shtohet popullsisë së shtetit për llogaritjen e shkallës së kontributeve të tij.

[5] Konferenca e përgjithshme e Njëmbëdhjetë, e Gjashtëmbëdhjetë dhe e Tetëmbëdhjetë, kanë miratuar dispozita të reja që i bëjnë të pavlefshme ato të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni 20. Këto dispozita të reja frymëzohen nga rregullat e zbatuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për llogaritjen e kontributeve, duke mbajtur një përqindje maksimale dhe minimale kontributi.

6. Kur një koloni e njohur si autonome do të dëshirojë të aderojë në Konventë, ajo do të konsiderohet, për sa i përket hyrjes së saj në këtë Konventë, sipas vendimit të Metropolit, ose si e varur nga Metropoli, ose si një shtet kontraktues.

Neni 21 (1875)

Shpenzimet e prodhimit të prototipave ndërkombëtarë, si dhe të etalonëve dhe kopjeve të destinuara për t'i shoqëruar ato, do të përballohen nga Palët e Larta kontraktuese, sipas shkallës së vendosur në nenin e mëparshëm.

Shpenzimet e krahasimit dhe të verifikimit të etalonëve të kërkuara nga shtetet që nuk marrin pjesë në këtë Konventë do të rregullohen nga Komiteti sipas taksave të caktuara në bazë të nenit 15 të Rregullores.

Neni 22 (1875)

Kjo Rregullore do të ketë të njëjtën fuqi dhe vlerë me Konventën të cilës i bashkëngjitet.

Non authoritative English version
of the authoritative French text

THE METRE CONVENTION

SIGNED IN PARIS ON 20TH MAY 1875
MODIFIED BY THE CONVENTION SIGNED AT SÈVRES
ON 6TH OCTOBER 1921
AND
ANNEXED REGULATIONS

The most recent edition of the official French text was published by the BIPM in 1991.

NOTICE

The Metre Convention, signed in Paris on the 20th of May 1875, contains 14 Articles and is associated with annexed Regulations containing 22 Articles.

Article 19 of the Regulations has been modified by the Fourth General Conference (1907).

A number of Articles of the Convention and the Regulations have been modified by the International Convention signed at Sèvres on the 6th of October 1921.

The following text takes into account these modifications. The date on which the present text came into force is mentioned beside each Article.

THE METRE CONVENTION

FIRST ARTICLE (1875)

The High Contracting Parties undertake to create and maintain, at their common expense, a scientific and permanent *International Bureau of Weights and Measures* with its headquarters in Paris[1].

ART. 2 (1875)

The French Government will take the necessary steps to facilitate the acquisition or, if the case arises, the construction of a building specifically dedicated to this purpose, in accordance with the conditions set out in the Regulations annexed to the present Convention.

ART. 3 (1875)

The International Bureau shall operate under the exclusive direction and supervision of an *International Committee for Weights and Measures*, itself placed under the authority of a *General Conference on Weights and Measures*, consisting of the delegates of all the contracting Governments.

ART. 4 (1875)

The Presidency of the General Conference on Weights and Measures is assigned to the then current President of the Paris Academy of Sciences.

[1] *Decree No. 70-820 of 9 September 1970 publishing the Agreement between the Government of the French Republic and the International Committee for Weights and Measures on the headquarters of the International Bureau of Weights and Measures and its privileges and immunities on the French territory of 25 April 1969 (published in the journal officiel de la République française of 18 September 1970), amended by the agreement dated 7 June 2005 and the exchange of letters dated 6 and 23 July 2007, ratified by the law No. 2008-738 dated 28 July 2008 (published in the journal officiel de la République française of 30 July 2008).*

ART. 5 (1875)

The organization of the Bureau, as well as the composition and attributions of the International Committee and of the General Conference on Weights and Measures, are determined by the Regulations annexed to the present Convention.

ART. 6 (1875)

The International Bureau of Weights and Measures is charged with:

1° all comparisons and verifications of the new prototypes of the metre and the kilogram;

2° the conservation of the international prototypes;

3° the periodic comparisons of national standards with the international prototypes and their official copies as well as those of the standard thermometers;

4° the comparison of the new prototypes with the fundamental standards of non-metric weights and measures used in different countries and in the sciences;

5° the calibration and comparison of geodetic standards;

6° the comparison of precision standards and scales whose verification may be requested, either by Governments, by learned societies or even by *des artistes et des savants (Note: at the time of the signature of the Convention "artistes" and "savants" referred respectively to craftsmen (artisans) who made precision standards and scales and to individual scientists.)*

ART. 7 (1921)

After the Committee will have carried out the work of coordination of measurements related to electrical units, and when the General Conference shall have so decided by unanimous vote, the Bureau will be charged with the establishment and the conservation of standards of electrical units and their official copies as well as the comparison with these standards of national standards or other precision standards.

The Bureau is also charged with determinations related to physical constants for which more accurate knowledge might serve to increase the precision and ensure better uniformity in the fields to which the units mentioned above belong (Article 6 and 1st paragraph of Article 7).

Finally, it is charged with the work of coordinating similar determinations made in other institutes.

ART. 8 (1921)

The international prototypes, as well as their official copies, shall remain deposited in the Bureau; access to the depository shall be reserved solely to the International Committee.

ART. 9 (1875)

All the costs of the establishment and installation of the International Bureau of Weights and Measures, as well as the annual expenses for its maintenance and those of the Committee, shall be covered by the contributions of the contracting States established according to a scale based on their current population.

ART.10 (1875)

The sums representing the contributive parts of each of the contracting States shall be paid at the beginning of each year through the intermediary of the Foreign Ministry of France, to the *Caisse des dépôts et consignations* in Paris, from which they will be withdrawn, from time to time as required, on the orders of the Director of the Bureau.

ART.11 (1875)

Governments that would make use of the option, available to any State, to accede to the present Convention, shall be required to pay a contribution of an amount that will be determined by the Committee under the conditions established in Article 9 and which shall be allocated for the improvement of the scientific equipment of the Bureau[2].

ARTICLE III
(provisions added by the Convention of 1921)[3]

Any State may accede to the present Convention by notifying its accession to the French Government, which will then give notice to all participating States and the President of the International Committee for Weights and Measures.

Any new accession to the Convention of 20 May 1875 will carry with it obligatory accession to the present Convention.

ART. 12 (1875)

The High Contracting Parties reserve the right to make by common accord any changes to the Present Convention that experience may show to be useful.

ART. 13 (1875)

At the end of a period of twelve years, the present Convention may be denounced by one or other of the High Contracting Parties.

The Government using the right that the Convention cease its effects as far as it is concerned shall be required to notify its intention one year in advance and by so doing shall give up all its joint ownership rights on the international prototypes and on the Bureau.

ART. 14 (1875)

The present Convention shall be ratified in accordance with the specific constitutional laws of each State; the ratifications shall be exchanged in Paris within a period of six months and sooner if possible. It will take effect from 1 January 1876.

In testimony whereof, the respective plenipotentiaries have signed it and affixed their seals.

---

[2] The International Committee for Weights and Measures at its 49th session (October 1960) decided that the contribution (entry contribution) mentioned in Article 11 shall, from 1 January 1961, be equal to the amount of an annual contribution.

[3] See the Notice on page 3.

ANNEX

REGULATIONS

FIRST ARTICLE (1875)

The International Bureau of Weights and Measures shall be established in a special building having all the necessary qualities of tranquillity and stability.

It shall include, in addition to an appropriate place for the depository of the prototypes, rooms for the installation of comparators and balances, a laboratory, a library, a room for the archives, offices for the professional staff and lodgings for the caretakers and service staff.

ART. 2 (1875)

The International Committee is charged with the acquisition and appropriation of this building as well as the installation of the services for which it was destined

In the event that the Committee is unable to find a suitable building to acquire, it shall have one constructed under its direction and following its plans.

ART. 3 (1875)

The French Government, at the request of the International Committee, will take the necessary steps to have the Bureau recognized as an establishment *"d'utilité publique"*.

ART. 4 (1875)

The Committee shall have constructed the necessary instruments such as: line scale comparators, equipment for the determination of absolute coefficients of expansion, balances for weighing in air and in vacuum, geodetic tape and wire comparators, etc.

ART. 5 (1875)

The cost of the acquisition or the construction of the building and the expenses for installation and cost of the instruments and apparatus should not together exceed the sum of 400 000 francs.

ART. 6 (1921)

1. The annual dotation of the International Bureau is made up of two parts: one fixed, the other complementary.

2. The fixed part is, in principle, 250 000 francs but may, by unanimous decision of the Committee, be increased to 300 000 francs. It is a liability of all those States and independent Colonies that acceded to the Metre Convention before the Sixth General Conference.

3. The complementary part is made up of the contributions of those States and independent Colonies that entered into the Convention after this same General Conference.

4. The Committee is charged with drawing up, on the proposal of the Director, the annual budget not exceeding the sum calculated in accordance with the provisions of the two preceding paragraphs. Each year this budget is made known to the Governments of the High Contracting Parties in a special financial report.

5. In the event that the Committee deems it necessary, either to increase the fixed part of the annual dotation above 300 000 francs or to modify the calculation of contributions determined by Article 20 of the present Regulations, it should refer the matter to Governments to allow them to give, in good time, the necessary instructions to their delegates to the following General Conference, so that its deliberations may be valid. The decision shall be valid only in the case that none of the contracting States has expressed, or will express at the Conference, an opinion against[4].

6. If a State remains three years without paying its contribution, the said contribution is distributed among the other States pro-rata to their own contributions. The supplementary sums thus paid by these States to make up the dotation of the Bureau are considered as advances made to the State in arrears, and are reimbursed to them in the event that it repays its arrears of contributions.

7. The advantages and prerogatives conferred by accession to the Metre Convention are suspended for those States in arrears by three years.

8. After three more years, the State in arrears is excluded from the Convention and the calculation of contributions is re-established in accordance with the provisions of Article 20 of the present Regulations.

ART. 7 (1875)

The General Conference, mentioned in Article 3 of the Convention, shall meet in Paris, on the convocation of the International Committee at least once every six years.

Its mission is to discuss and instigate measures necessary for the propagation and improvement of the metric system as well as to approve new fundamental metrological determinations that might have been made in the interval between its meetings. It receives the Report of the International Committee on work accomplished and proceeds by secret ballot to the renewal of half of the International Committee.

Votes at a General Conference are made by States, each State has the right to one vote.

Members of the International Committee have a seat as of right at meetings of the Conference; they may, at the same time, be delegates of their Governments.

ART. 8 (1921)

The International Committee, mentioned in Article 3 of the Convention, shall be composed of eighteen members each belonging to a different State.

At the time of renewal of half of the International Committee, the outgoing members shall be first those who, in the case of vacancies, have been provisionally elected in the interval between two sessions of the Conference; the others shall be drawn by lot.

Outgoing members are eligible for re-election.

[4] By virtue of this procedure, since the Thirteenth General Conference on Weights and Measures (October 1960) annual dotations are adopted by each General Conference.

ART.9 (1921)

The International Committee shall be constituted by electing itself, by secret ballot, its President and its Secretary. These nominations shall be notified to the Governments of the High Contracting Parties.

The President and the Secretary of the Committee and the Director of the Bureau shall belong to different countries.

Once it is constituted, the Committee cannot proceed to new elections or nominations until three months after all members have been informed of the vacancy giving rise to a vote.

ART. 10 (1921)

The International Committee directs all metrological work the High Contracting parties shall decide to have carried out in common.

It is also charged with supervising the conservation of the prototypes and international standards.

Finally, it may initiate the cooperation of specialists in metrological matters and coordinate the results of their work.

ART.11 (1921)

The Committee shall meet at least once every two years.

ART. 12 (1921)

Voting in the Committee shall be by majority; in the case of a tie the President has a casting vote. Decisions are valid only if there are at least half of the elected members of the Committee present.

Provided this condition is met, absent members have the right to delegate their votes to members present who should justify this delegation. The same applies to nominations by secret ballot.

The Director of the Bureau has a vote in the Committee.

ART.13 (1875)

In the interval between sessions, the Committee has the right to deliberate by correspondence.

In this case, for a decision to be valid, all members of the Committee must have been invited to express their opinion.

ART. 14 (1875)

The International Committee for Weights and Measures provisionally fills vacancies that may occur; elections are made by correspondence, each member being invited to take part.

ART. 15 (1921)

The International Committee will draw up detailed regulations for the organization and the work of the Bureau and it will fix the fees to pay for the extra work foreseen in Articles 6 and 7 of the Convention.

These fees shall be used for the improvement of scientific apparatus of the Bureau. An annual levy in favour of the pension fund may be made from the total fees received by the Bureau.

ART. 16 (1875)

All communications of the International Committee with the Governments of the High Contracting parties shall be through the intermediary of their diplomatic representatives in Paris.

For all matters that require the intervention of a French administration for their solution, the Committee will address the Foreign Ministry of France.

ART. 17 (1921)

The maximum number in each category of Bureau staff will be fixed by a Regulation drawn up by the International Committee.

The Director and his *adjoints* will be nominated by secret ballot by the International Committee. Their nomination shall be notified to the Governments of the High Contracting Parties.

The Director will nominate the other members of the staff within the limits set out in the Regulation mentioned in the first paragraph above.

ART. 18 (1921)

The Director of the Bureau shall have access to the depository of the international prototypes only by virtue of a resolution of the Committee and in the presence of at least one of its members.

The place of the depository of the prototypes may only be opened by means of three keys, one of which will be held by the Director of the archives of France, the second by the President of the Committee and the third by the Director of the Bureau.

Only standards of the category of national prototypes shall serve for the ordinary work of comparisons of the Bureau.

ART. 19 (1907)

The Director of the Bureau shall present to the Committee at each session:

1° a financial report of the accounts of the previous exercise for which, after verification, he shall be given quittance;

2° a report on the state of the equipment;

3° a general report on the work accomplished since the last session,

The bureau of the International Committee shall, on its side, present to the Governments of the High Contracting Parties an Annual Report on the financial and administrative situation of the Service, and containing previsions for the expenses of the forthcoming exercise as well as a Table of the contributive parts of the contracting States.

The President of the Committee shall give an account to the General Conference of the work accomplished since the time of its previous meeting.

The reports and publications of the Committee and the Bureau shall be written in French and communicated to the Governments of the High Contracting Parties.

ART. 20 (1921)

1. The scale of contributions, mentioned in Article 9 of the Convention, is established for the fixed part on the basis of the dotation indicated in Article 6 of the present Regulations and on that of the population; the normal contribution of each State cannot be less than 5 in 1000, nor higher than 15 in 100 of the total dotation regardless of the population number.

2. To establish this scale, it is first determined which States meet the required conditions for this minimum and this maximum; then the remaining part of the total contribution is distributed among the other States directly in proportion to their population numbers[5].

3. The contributive parts thus calculated are valid for the whole of the period between two successive General Conferences and can be modified, in the interval, only in the following cases:

   a. If one of the Member States has let three successive years pass without making its payments;

   b. If, on the contrary, a State previously in arrears by more than three years, paid its arrears of contributions, then the advances made by the other Governments are returned to them.

4. The complementary part of the contribution is calculated on the same basis of the population, and is equal to that which States previously entered the Convention would pay under the same conditions.

5. If a State, having acceded to the Convention, declares a wish to extend the benefits to one or more of its dependent Colonies, the number of the population of these Colonies shall be added to that of the State for the calculation of the scale of contributions.

6. When a Colony recognized as autonomous, desires to accede to the Convention, it shall be considered as regards its entry to the Convention, following the decision of the Mother State, either as a dependence of that State or as a contracting State.

ART. 21 (1875)

The costs of the fabrication of the international prototypes as well as the standards and official copies destined to accompany them shall be supported by the High Contracting Parties according to the scale established in the previous Article.

The costs of comparison and verification of standards requested by States that would not be participants in the present Convention shall be set by the Committee in accordance with the fees fixed by virtue of Article 15 of these Regulations.

ART. 22 (1875)

The present Regulations have the same force and value as the Convention to which they are annexed.

[5] The Eleventh, the Sixteenth and the Eighteenth General Conferences have adopted new provisions that render null and void those of paragraphs 1 and 2 of this Article 20. These new provisions are inspired by the rules applied by the United Nations Organization for the calculation of its contributions while maintaining a maximum and minimum percentage of contribution.